



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:015627
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05739712

K.DH.SH.II.nr.935/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Posta e Kosovës me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Ministria e Infrastrukturës, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike Përgjithshëm, KPPP.nr.1164/24 i dt.05.02.2024, me datën 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Posta e Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike Përgjithshëm, KPPP.nr.1164/24 i dt.05.02.2024,, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për Çështje Ekonomike Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor KPPP.nr.251/24 i dt.20.12.2022 i lëshuar nga Përmbartuesi seli ne Prishtinë, ndërsa përfundohet procedura përmbartimore ne këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles së Dytë, të nxjerr aktvendim me të cilin aprovohet në tërësi ankesa e ushtruar nga kreditori, si e bazuar, dhe te mbetet ne fuqi urdhrin përmbartimor ose lenden ta kthej ne rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave të përshkruara në propozimim të urdherit përmbartimor. Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor KPPP.nr.251/24 i dt.20.12.2022, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga faturat t'i paguaj shumën prej 244.37 euro, me kamatë prej 8% si dhe shpenzimet tjera të procedurës.

Kundër urdherit përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me pretendimin se të ndërprite procedura dhe lënda të dërgohet në gjykatë të rregull.

Gjykatës Komerciale, Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendim të ankimuar, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se faturat mbi bazën e cilave është lejuar përmbartimi janë pranuar nga debitori, të njëjtat fatura nuk janë nënshkruar nga personi-subjekti në emër dhe mbiemër dhe si të tilla nuk përbejnë bazë për përmbartim, ndërsa kreditori nuk ka mundur të argumentoj pretendimet e tij me asnjë provë të cilat do të ndikonin në një vendosje ndryshe nga ka vendosur në dispozitiv të aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk kanë qenë të nënshkruar nga pranuesi i faturës, e që në këtë rast nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm. Neni 29 par.1 nënpar.1.1 përcakton se: “ 1. Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1 kambialet dhe çequet me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës”. Në këtë rast e rëndësishme është që të vërtetohet se a është pranuar fatura nga ana e debitorit, pra e njëjta a është nënshkruar sepse kjo nënkupton se debitori i ka pranuar detyrimet e tij që i ka ndaj kreditorit.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i

bazuar. Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Gjykata e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Gjykata pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se faturat si dokumente në sajë të cilave kreditori kërkoi përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se janë pranuar nga debitori, të njëjta nuk janë të vullosura e as nënshkruar nga debitori në mënyrë që të konsiderohen si dokumente të besueshme, ndërsa vlerëson se me të drejtë gjykata e shkalles së parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.935/24, me datë 24.05.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi